

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2023*

**20.03.2023
Ora 15:19**

RENDI I DITËS

Projektakti "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 34 të depozituar nga Partia Bindja Demokratike".


PJESËMARRJA :

- **KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike: Partia Bindja Demokratike**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. E. Lako: Mirëdita! Çelim seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbatjes për çështjen ankimore nr.34, me subjekt ankues Partia Bindja Demokratike për kundërshtimin e vendimit të Komisionerit nr.170 të datës 11 Mars 2023. Relatori i kësaj çështje jam unë, Elvin Lako sipas shortit të hedhur me datë 18 Mars 2023, mbështetur në nenin 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë është trupa e KAS të gjithë anëtarët e KAS, Sekretari i Përgjithshëm që përfaqëson administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përfaqësuesi i subjektit ankues, ju lutem?

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Fabian Topollaj përfaqësues me autorizim.

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2023*

Z. E. Lako: Faleminderit! Palë të interesuara nuk ka. Atëhere, shumë shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm në lidhje me plotësimin e elementët e formës dhe të përmbatjes dhe dy fjalë në lidhje me këtë ankim.

Z. Y. Merkaçaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr.34 me ankues Partia Bindja Demokratike me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 170 datë 11.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia Bindja Demokratike për rregjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Nga verifikimi i elementëve formal të kërkesës, konstatohet se kompetenca e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit është e plotësuar, legjitimimi i ankuesit është i plotësuar pasi ka interes të ligjshëm për ngritjen e kësaj ankese. Ndërsa afatet ligjore nuk janë respektuar pasi është jashtë afatit ligjor 3 ditor të përcaktuar në vendimin numër 170 të Komisionerit, data e vendimit të marrë 11.03.2023 ankensa është depozituar me datën 17.03.2023 domethënë 6 ditë më vonë. Në këto kushte kërkojmë nga KAS të mos kalojë për shqyrtim Kërkesa Ankimore nr.34. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Sekretar i Përgjithshëm! Atëhere, ju lutem pala e interesuar nëse keni diçka për të thënë në lidhje me këto që dëgjuat pra, në lidhje me plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbatjes së ankimit?

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Është e vërtet e gjithë parashtrësja që bëri Sekretari i Përgjithshëm. Është po ashtu e vërtet që kërkesa jonë ankimore për shkak të një gabimi formal është bërë jashtë afati, kështu që unë e lë në gjykimin tuaj nëse kjo kërkesë ankimore do të shqyrtohet apo jo.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2023*

Z. E. Lako: Mund të na e specifikosh këtë gabimin formal që sapo thatë, në lidhje me çfarë ju pengoi ose çfarë ndodhi që nuk u respektua ky afat?

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Ndodhi një gabim që ne bëmë për afatin kohor, një gabim ligjor nga ana jonë. Kështu që e lemë në çmimin tuaj që...

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! Nga ana e anëtarëve ka ndonjë pyetje në lidhje me palën e interesuar? Jo, nuk ka pyetje! Atëherë, do të tërhiqemi për vendim. Atëhere, për arsyet që pak a shumë u përmëndën që mos ti përsëris edhe nga Sekretari i Përgjithshëm. Meqenëse afati i ankimit nuk është respektuar në përputhje me nenin 124 të Kodit Zgjedhor, është shkelur dukshëm ky afat dhe nuk ka ndonjë argument ligjor që ta legjitimoj këtë. KAS i konsultuar në vend vendosi: Moskalimin e ankimit për shqyrtim për shkak të elementëve të përcaktuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve. E deklarojmë të mbyllur seancën faleminderit!

Vendimi nr. 28

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



RENDI I DITËS

**Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 35 të Partisë
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar".**

PJESËMARRJA :


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** LZHK
- **Të tjerë:**

Z. E. Çefa: Mirëdita! Atëherë, fillojmë seancën e shqyrtimit të elementëve paraprakë të kërkesës ankimore me nr.35, me subjekt ankimues Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, me objekt ankimimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 173 datë 14 Mars 2023. Verifikojmë prezencën, është prezent KAS, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Është prezente edhe pala ankuese përfaqësuar nga zoti...

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Fabian Topollari, me autorizim nga Kryetari i partisë.

Z. E. Çefa: Relator i kësaj kërkesë ankimore në bazë të shortit të hedhur me datën 18 Mars jam caktuar unë, Elvis Çefa. Paraprakisht ndonjë kërkesë zoti Topollari lirdhur me përbërjen e trupës së KAS?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2023*

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Jam dakord nuk ka asnjë kërkesë.

Z. E. Çefa: Nga kolegët ndonjë deklaratë paraprake? Nuk ka! Kështu që mund të vazhdojmë! Ja kaloj fjalën Sekretarit të Përgjithshëm për të parashtruar shkurtimisht kërkesën dhe plotësimin e elementëve formal që kërkon Kodi Zgjedhor për të.

Z. Y. Merkaç: Në datën 14 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar kërkesën e partisë politike Lëvizja për Zhvillim Kombëtar për rregjistrimin si subjekt zgjedhor për rregjistrimin si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri ka vendosur rregjistrimin e partisë politike Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me Kryetar zotin Dashmir Shehi, me shkronjat nistore LZHK si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kundër këtij vendimi ka bërë ankesë partia politike Lëvizja për Zhvillim Kombëtar duke mos qenë dakord me këtë vendim. Me datën 17.03.2023 ka paraqitur ankesën duke kundërshtuar vendimin nr.173 datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i elementëve formal konstatohet se i plotësojnë të tre elementët si kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, legjitimitimin e ankuesit dhe respektimin e afatit ligjor të ankimit i cili është bërë 3 ditë pas duke filluar nga dita e shpalljes është paraqitur ankimi. Kështu që i plotëson të gjithë elementët dhe propozojmë të kalohet për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Përfaqësuesi i ankuesit ndonjë diçka, gjithmonë lidhur me këtë fazë të procesit ?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.20.03.2023*

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Jo, si parafolësi përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ne mendojmë që janë plotësuar të tre elementët e formës që çështja të kalojë për shqyrtim nga ana juaj.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Pyetje nga kolegët? Nuk ka! Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi: Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr.35, me subjekt ankimues Partinë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar kundër vendimit të Komisionerit me nr. 173 datë 14.03.2023. Seanca e themelit do të caktohet nesër ditë e Martë datë 21 Mars në orën 12 e 30. Seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 29

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

